NJOFTIM PËR KONKURSIN E KRIJIMTARISË DIGJITALE TË NXËNËSVE

të programit "Liderët e ardhshëm të integritetit"

"Konkursi – Integriteti është Cool"

Qëllimet dhe objektivat

Konkursi i krijimtarisë digjitale të nxënësve "Integriteti është Cool" iu drejtohet të gjithë nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme në të gjithë vendin, si publike ashtu edhe private, me miratimin e Drejtorisë dhe shoqatës së mësimdhënësve të çdo njësie shkollore. Konkursi realizohet në kuadër të projektit evropian Liderët e ardhshëm të Integritetit, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes programit Erasmus+.

Qëllimi kryesor është të rritet kuptimi dhe rëndësia e integritetit në jetën e përditshme të nxënësve, përmes shprehjes artistike dhe krijuese, por edhe t'i fuqizojë ata që të kuptojnë se vetë, me veprimet dhe zgjedhjet e tyre, mund të ndikojnë pozitivisht në të ardhmen e tyre dhe të shoqërisë. Konkursi zhvillohet paralelisht në Greqi, Bullgari, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, duke forcuar shkëmbimin ndërkulturor dhe reflektimin e përbashkët mbi vlerën e integritetit. Objektivat individuale përfshijnë:

- Të reflektohet dhe të inkurajohen nxënësit të shprehin se çfarë do të thotë për ta „integritet".
- Të nxitet të menduarit kreativ, qëndrimi hulumtues dhe bashkëpunimi.
- Të nxitet shprehja e lirë, e përgjegjshme dhe kritike e nxënësve.
- Të ofrohet një kuadër përmes të cilit nxënësit mund të përdorin media digjitale bashkëkohore me orientim pedagogjik dhe arsimor.

Kush mund të marrë pjesë

- Nxënës të shkollave fillore dhe të mesme (13-17 vjeç).
- Pjesëmarrja është e pranueshme vetëm në grupe (2-3 nxënës për grup).
- Me mbështetjen e të paktën një mësimdhënësi/ mësimdhënëse nga kuadri shkollor.

Specifikimet e projekteve digjitale

- **Formati:** animacion, skicë, dokumentar i shkurtër, tregim digjital.
- **Kohëzgjatja:** 30 deri 60 sekonda.
- **Dimensioni**: video në format vertikal për ta bërë më të lehtë shikimin në pajisje celulare.
    - Raporti 9:16 (gjerësi : lartësi) është standard për videot vertikale.

  - Përmasa të zakonshme vertikale: 1080 pikselë gjerësi me 1920 pikselë lartësi.
- **E detyrueshme:** Deklarata për pëlqim për pjesëmarrje nga prindi/kujdestari, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rast përdorimi të materialeve të palëve të treta (muzikë, imazhe, tekste), kërkohet referencë e burimeve dhe respektim i të drejtave të autorit.

Tematika

Situata nga jeta e përditshme që theksojnë vlerën e integritetit, me theks në fenomenet që nxënësit duhet t'i kuptojnë, t'i refuzojnë dhe t'i trajtojnë me përgjegjësi, si p.sh.:

- *Bullizmi (dhunë verbale ose fizike mes nxënësve)*
- *Kopjimi, mashtrimi ose plagjiatura në detyra dhe teste*
- *Sjellja e papërshtatshme e mësimdhënësve ndaj nxënësve (fyerje, bullizëm)*
- *Sjellja e papërshtatshme e nxënësve ndaj mësimdhënësve (mungesë respekti, kërcënime)*
- *Akte të vandalizmit në mjedisin shkollor*
- *Diskriminim mbi bazën e orientimit seksual, aftësisë së kufizuar ose vështirësive në të mësuarit*
- *Vjedhje të gjërave të vogla dhe fshehja e sendeve*
- *Komente seksiste ose diskriminim mbi bazën gjinore*
- *Ngacmim seksual, qoftë verbal ose fizik*
- *Përpjekje për manipulimin e rezultateve të votimeve shkollore për shpërblim*
- *Diskriminim social ose ekonomik midis bashkëmoshatarëve*

Nxënësit mund të frymëzohen nga përvojat ose vëzhgimet e tyre dhe në mënyrë krijuese të tregojnë se si një qëndrim i ndershëm, i drejtë dhe i përgjegjshëm mund të sjellë ndryshime pozitive si në afatshkurtër, ashtu edhe në atë afatgjatë.

Procesi i pjesëmarrjes

1. Dorëzimi i Deklaratës së Pjesëmarrjes deri më 20/10/2025 në faqen e konkursit: www.integrityis.cool.
2. Dorëzimi i punimeve digjitale deri më 20/10/2025.
3. Pjesëmarrja nënkupton pranimin e plotë të kushteve të këtij njoftimi.

Vlerësimi dhe Çmimet

Punimet do të vlerësohen nga një juri me 5 anëtarë mbi bazën e kritereve pedagogjike dhe krijuese.

Do të jepen çmime:

- **2 çmime nga juria (fituesit do të përzgjidhen nga juria).**
- **Çmimi i publikut (nëpërmjet votimit digjital).**

Projektet fituese do të prezantohen në aktivitetet e diseminimit (konferenca, seminare, shfaqje edukative, rrjete sociale) dhe do të përfshihen në materialet informuese që lidhen me integritetin në arsim.

Çmimet

- Tre ekipe fituese në secilin shtet do të marrin çmime.
- Çdo nxënës i 3 ekipeve fituese nga Maqedonia e Veriut do të merr nga një kamerë aksioni për të vazhduar zhvillimin e aftësive të tij/saj në krijimin e përmbajtjes edukative dhe sociale.
- Fituesit do të ftohen të marrin pjesë në konferencën përfundimtare të projektit "Liderët e ardhshëm të integritetit" në Selanik, Greqi, ku do të zhvillohet edhe ceremonia e ndarjes së çmimeve.

Mbështetje – Kontakt

Për informacione dhe sqarime:

- Email: integrityiscool.gr@gmail.com dhe info@eunoia.mk
- Uebfaqe: www.integrityis.cool
- Faqet tona në rrjetet sociale.

